

URDHËR
Nr. 44, datë 17.1.2025

**PËR PËRDITËSIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 275, DATË 5.5.2023,
“PËR MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE DHE PËRBËRËSVE TË TJERË, NË
PËRMBAJTJE TË PMB-ve”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

- Në urdhrin e ministrit nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:
 - në pjesën B, të shtojcës 1, miratohet për shtim 1 (një) lëndë vepruese bazike, bashkëlidhur këtij urdhri;
 - miratohet vlefshmëria e regjistrimit për 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;
 - zgjaten afatet e regjistrimit për 13 (trembëdhjetë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;
 - nuk miratohet si lëndë vepruese bazike (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;
 - hiqen 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.
- Përditësimi sipas shkronjave “b” dhe “c” të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.
- Për PMB-të e regjistruara me përmbajtje të lëndëve vepruese sipas shkronjës “d”, çregjistrimi dhe heqja nga tregu të kryhen brenda afateve të përcaktuara sipas këtij urdhri, si dhe të njoftohen Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, si dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.
- Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

1. MIRATOHET PËR SHTIM NË PJESËN B, TË SHTOJCËS 1, LËNDA VEPRUESE BAZIKE SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Dispozita specifike
1	<i>Allium fistulosum</i> CAS No: Nuk disponohet CIPAC No: Nuk disponohet	Nuk disponohet	----- ---	1 dhjetor 2024	<i>Allium fistulosum</i> , i përpunuar, do të përdoret në përputhje me kushtet specifike të përfshira në konkluzionet e raportit rishikues për <i>Allium fistulosum</i> , të përpunuar, (PLAN/2024/798) dhe në veçanti shtojcat I dhe II të tij.

2. MIRATOHET VLEFUSHMËRIA E REGJISTRIMIT PËR 2 (DY) LËNDË VEPRUESE, SI MË POSHTË:

Deri më 15 janar 2025:

- Fenpyrazamine;

2. Flumetralin.

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

3. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

- **Deri më 31 dhjetor 2025:**

1. 8-hydroxyquinoline.

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- **Deri më 15 shkurt 2027:**

1. Fluroxypyr.

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- **Deri më 31 maj 2027:**

1. Azoxystrobin;

2. Imazalil;

3. Kresoxim-methyl;

4. Tefluthrin;

5. Oxyfluorfen;

6. Terbutylazine;

7. *Candida oleophila* strain O;

8. *Paecilomyces fumosoroseus* strain FE 9901;

9. Chlorantraniliprole;

10. Metobromuron;

11. Aminopyralid.

Gjithsej: 11 (njëmbëdhjetë) lëndë vepruese.

4. MOSMIRATIM I LËNDËS VEPRUESE BAZIKE SI MË POSHTË:

1. 1,3,7-trimethylxanthine (caffeine)

Substanca *1,3,7-trimethylxanthine (caffeine)* nuk miratohet si lëndë vepruese bazike.

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

5. HEQJE REGJISTRIMI PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. Metribuzin

Nuk rinovohet për miratim lënda vepruese metribuzin.

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë metribuzin, brenda datës 24 maj 2025.

Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë metribuzin, të përfundojë brenda datës 24 nëntor 2025.

2. Tritosulfuron

Nuk rinovohet për miratim lënda vepruese tritosulfuron.

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë tritosulfuron, brenda datës 7 maj 2025.

Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë tritosulfuron, të përfundojë brenda datës 7 nëntor 2025.

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.